



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 413/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Milazim Haliti, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në të cilën thekson se 25 votat e tij i janë shënuar gabimisht kandidatit me numër 73. Këtë gabim sipas parashtruesit të ankesës e pranon edhe komisionari i vendvotimit 2503D/05D dhe si dëshmi ka bashkangjitur edhe FRK-në.

Bazuar në nenin 117.2 të LZP-së PZAP-i *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”*

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga Milazim Haliti kandidat për deputet nga subjekti politik LDK, dhe në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për të bërë hetimin rreth numërimit të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon se votat e tij i janë regjistruar kandidatit tjetër nga subjekti politik LDK.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2503D/05D e cila kuti ka qenë e mbyllur me 4 shirita anësor të sigurisë të cilët shirita kanë mbajtur këta numra: 113412, 113415, 113414 dhe 113413 si dhe me shiritin e sigurisë i cili gjendej në mes të kutisë së votimit me numër 113411 e i cili shirit nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-i pas hapjes së kutisë së votimit me nr 2503D/05D ka konstatuar se nga FRK-ja origjinale që gjendej në QNR kandidati me nr. 74 nga subjekti politik LDK i posedon 20 vota dhe se pas numërimit të fletëvotimeve të kësaj kutie ka gjetur 20 fletëvotime të vlefshme të cilat kanë qenë për kandidatin me nr 74 dhe se të gjitha këto kanë qenë të shënuara edhe në FRK-në.

Andaj pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë për mungesë të votave dhe regjistrimit të tyre në FRK për kandidatin tjetër janë të pabazuara.

PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 413/2014 më datën 30.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.